VENDIM
Nr. 710, datë 23.11.2018

PËR LEJIMIN E KRYERJES SË PROCEDURAVE TË ZHDOGANIMIT DHE TË KONTROLLEVE FIZIKE NGA ZYRTARËT E ZYRËS DOGANORE TË KOSOVËS NË PORTIN E DURRËSIT DHE PORTO-ROMANO DHE NJOHJEN E LICENCAVE TË AGJENCIVE TË PËRFAQËSIMIT DOGANOR TË KOSOVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, pika 3, 48, pika 3 dhe 288, të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Zyrës Doganore të Republikës së Kosovës të kryejë procedura doganore në Portin e Durrësit dhe Porto-Romano, për zhdoganimin e mallrave që kanë destinacion hedhje në qarkullim të lirë/destinacion final të përdorimit në Republikën e Kosovës. Për këtë qëllim, zyrtarët/oficerët doganorë të doganës së Kosovës kryejnë në Portin e Durrësit dhe Porto-Romano procedurat e kontrollit/ekzaminimit fizik të mallrave.

2. Bazuar në indikatorët dhe analizën e riskut, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, përgatit listën e mallrave me risk, për të cilat nuk mund të zbatohet procedura e referuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Punonjësit doganorë të Doganës Durrës bashkëpunojnë dhe shoqërojnë zyrtarët e Doganës së Kosovës në kryerjen e funksioneve të tyre. Me përfundimin e procedurave të kontrollit nga zyrtarët e Doganës së Kosovës, vijohet me formalitetet doganore shqiptare.

Në rastet kur gjatë kontrolleve të kryera nga personeli zyrtar i Doganës së Kosovës konstatohen mallra të ndaluara apo trafikim i qenieve njerëzore, njoftohen menjëherë organet e policisë dhe ato doganore shqiptare.

Dega e Doganës Durrës u mundëson zyrtarëve të Doganës së Kosovës përdorimin e peshores apo të mjeteve të tjera në administrim të saj, për ushtrimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Për kryerjen e deklarimit në përputhje me pikën 1, të këtij vendimi, dhe të veprimeve të transitit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë vendosjen e garancisë për borxhin e mundshëm në këtë regjim, njihen licencat e agjencive doganore të Republikës së Kosovës.

Pas dorëzimit zyrtar të listës dhe të kopjeve të licencave nga Dogana e Kosovës, këto agjenci regjistrohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me qëllim njohjen dhe regjistrimin nga Dogana e Kosovës, dërgon pranë kësaj të fundit listën dhe kopje të licencave të agjencive doganore të Republikës së Shqipërisë.

5. Autoriteti Portual i Durrësit, Ministria e Brendshme apo subjektet e tjera të përfshira sigurojnë lejet e hyrjes për zyrtarët e Doganës së Kosovës, në ambientet e Portit të Durrësit dhe Porto-Romano, sipas listës që dërgohet nga Dogana e Kosovës dhe konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Zyrtarët e Doganës së Kosovës ushtrojnë funksionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, me uniformë apo me kostume civile me jelek me shenja identifikuese të Doganës së Kosovës. Mjetet e transportit të Doganës së Kosovës lejohet të kenë mbishkrimet dalluese të saj.

6. Autoriteti Portual i Durrësit apo subjektet e përfshira mundësojnë furnizimin me ujë, energji, lejimin e sjelljes së pajisjeve për mobilimin e zyrave dhe gjetjen e hapësirave për zyra dhe të një sheshi për kontroll fizik, ku zyrtarët e Doganës së Kosovës të kenë mundësi të kryejnë funksionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

Zyra doganore e Kosovës lidh kontratat përkatëse, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama